



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:191369
Datë: 26.09.2024
Numri i dokumentit: 06211729

Ac.nr.766/2020

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Hunaida Pasuli – Kryetare e kolegjit, Nehat Idrizi dhe Burim Shala anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I. B. nga P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.Q., avokat nga P., kundër të paditurës A. e S. të K., me seli në P., të cilën më autorizim e përfaqëson Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore, me bazë juridike kompensimi i të ardhurave personale, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr. 3400/2018 të datës 10.09.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e të paditurës A. e S. të K., me seli në P., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.3400/2018 i datës 10.09.2019, VËRTETOHET

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë me aktgjykimin C.nr.3400/2018 të datës 10.09.2019, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit I.B.nga P. kundër të paditurës A.e S. të K., me seli në P.. Në pikën II të dispozitivit detyrohet e paditura A.e S. të K., me seli në P., që paditësit në emër të pagave neto të papaguara për periudhën nga data 02.10.2006 - 02.02.2009, t'ia paguaj shumën prej 8,288.83 €, po ashtu në emër të kontributit pensional për periudhën nga data 02.10.2006 deri me 01.02.2009, të paguaj shumën prej 915.00€ në Trustin Pensional të Kursimeve Personale të Kosovës, si dhe në emër të tatimit të të ardhurave, në emër të paditësit të paguaj shumën prej 403.74 € në Administratën Tatimore të Kosovës, e të gjitha me kamatë siç e llogarisin bankat vendore për deponimet në kursim, pa destinim të caktuar mbi një vit, dhe atë nga data 20.11.2007 (datë e paraqitjes së padisë) e deri në pagimin definitiv, në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të

dhunshëm. Në pikën III të dispozitivit e ka detyruar të paditurën A. e S. të K. me seli në P., që paditësit I. B. nga P., t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumën prej 405.60 €, në afatin prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta ndryshoj aktgjykimin C.Nr.3400/18 të datës 10.09.2019 dhe ta refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) gjeti se:

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi I.B. nga P., ka inicuar procedurën kontestimore përmes padisë së parashtruar me datë 20.11.2007 në gjykatën e shkallës së parë, me kërkesë që të anulohet vendimi i Kryeshefit ekzekutiv të E. S. të K., tani A.S.e K.dhe të detyrohet e paditura që paditësin ta kthejë në vendin e punës me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, më gjerësisht si në padi.

Duke vepruar sipas padisë, gjykata komunale në Prishtinë, si gjykatë e shkallës së parë me aktgjykimin C1.nr.502/2007, datë 06.05.2008, ka vendosur të miratohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, duke e anuluar si të kundërligjshëm vendimin e të paditurës me të cilin paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Po ashtu, detyrohet e paditura që paditësin ta kthejë në vendin e punës Drejtor i Departamentit të Administratës ose në tjera punë dhe detyra që përkojnë me përgatitjen profesionale të paditësit, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës nga data 02.10.2006 e deri në kthimin definitiv në punë. Aktgjykimi në fjalë është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac.nr. 1188/2008, datë 21.11.2008, e cila si gjykatë e shkallës së dytë ka vendosur lidhur me ankesën e paraqitur nga pala e paditur.

Sipas revizionit të ushtruar nga pala e paditur, Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin Rev.nr. 147/2009, datë 02.05.2012, ka vendosur që të priset aktgjykimi i gjykatave të instancës së parë dhe të dytë në pjesën në të cilën paditësit i njihen të drejtat nga marrëdhënia e punës nga data 02.10.2006, e deri në kthimin definitiv në punë, duke e kthyer çështjen në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim. Ndërsa revizioni është refuzuar si i pabazuar ndaj aktgjykimit për anulimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe detyrimin e të paditurës që paditësin ta kthejë në vendin e punës.

Në çështjen e kthyer në rigjykim, gjykata e shkallës së parë me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, caktoi seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën paditësi ka precizuar padinë duke parashtruar se të drejtat nga marrëdhënia e punës, i referohen kompensimit të pagës për periudhën kohore nga ndërprerja e marrëdhënies së punës, e deri në kthimin në punë, e që përfshin periudhën kohore nga data 02.10.2006, deri me datën 02.02.2009. Në seancën e shqyrtimit kryesor gjykata zhvilloi procedurën për administrimin e provave dhe pas vlerësimit të të gjitha veç e veç dhe në ndërlidhje me njëra tjetrën erdhi në përfundim që kërkesëpadia për kompensimin e pagave për periudhën kohore kohore nga data 02.10.2006 e deri më 02.02.2009, në lartësinë e pasyruar si në ekspertizën financiare, është e bazuar prandaj, kërkesëpadinë e aprovoi në tërësi duke vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit.

Në pjesën e arsytimit të aktgjykimit, gjykata ka parashtruar se nga provat e administruara, e në veçanti nga aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Prishtinë C1.n. 502/2007, datë 06.05.2008; aktoj gjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.1188/2008 dhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 147/09, është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë, pasi me këto aktgjykime, vendimi kontestues i të paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit, është gjetur si i kundërligjshëm dhe si i tillë është anuluar me aktgjykim të formës së prerë. Prandaj, për vlerësimin e lartësisë së kërkesëpadisë gjykata ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare, të plotësuar me datë 04.09.2019, nga e cila provë është konstatuar dëmi i shkaktuar paditësit për shkak të ndërprerjes së kundërligjshme të marrëdhënies së punës. Nga ekspertiza ka rezultuar se paditësit për periudhën nga data 02.10.2006 e deri me datë 01.02.2009, në emër të pagave neto të parealizuara i takon shuma prej 8,288.83 €, ndërsa shuma prej 915.00 € duhet transferuar në Trustin e Kursimeve Pensionale, si dhe shuma prej 403.74 €, duhet paguar në Administratën Tatimore të Kosovës, në emër të tatimit në të ardhura. Gjykata ekspertizën financiare e ka vlerësuar si profesionale dhe të argumentuar mirë, me arsytimin se e njëjta përmban të gjitha faktet për të përcaktuar lartësinë e pagave, andaj ia falë besimin sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë.

Për bazën juridike të kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë vendimin e ka mbështetur në dispozitat ligjore të nenit 49 dhe 51 të Ligjit për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës, si dhe nenit 154 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës e mbështeti në dispozitën e nenit 449 dhe 452.2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit, në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare. Gjykata e shkallës së parë ka aplikuar drejtë të drejtën materiale në raport me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë çështje juridike kontestuese, nga ku ka rrjedhur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, duke dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilët i ka kualifikuar në pajtim me normat materialo – juridike dhe ka nxjerrë përfundimin e drejtë me vendosjen meritorë si në aktgjykimin e atakuar, të vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) e LPK. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është hartuar në përputhje me dispozitën e nenit 160 të LPK-së, pasi që dispozitivi është i qartë, i përmbarueshëm dhe në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit. Gjykata në pjesën e arsytimit ka treguar se cilat prova ishin vendimtare për vërtetimin e bazës juridike të kërkesëpadisë dhe lartësisë së saj, përkatësisht baza juridike për njohjen e të ardhurave nga marrëdhënia e punës ka rezultuar sipas aktgjykimeve të tri insancave gjyqësore, të cilat kanë konstatuar se vendimi – objekt kontesti, me të cilin paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, paraqet një vendim të kundërligjshëm, e që si i tillë edhe është anuluar nga gjykata. Mbi këtë bazë, duke marrë parasysh periudhën kohore që paditësi është privuar kundërligjshëm nga realizimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës, si e drejtë themelore nga puna, gjykata në mbështetje të ekspertizës financiare e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj pagat nga dita e largimit nga puna e deri në datën kur paditësi është rikthyer në punë në shumën e konstatuar sipas ekspertizës financiare, e cila provë edhe nga kolegji i kësaj gjykate vlerësohet si e besueshme pasi është hartuar nga eksperti i autorizuar

gjyqësor, mbi bazën e njohurive profesionale dhe me referim në provat relevante nga të cilat vërtetohet lartësia e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit si të paqëndrueshme i vlerësoi pretendimet ankimore të të paditurës lidhur me gjendjen faktike të vërtetuar, e që sipas pretendimeve gjykata ia fali besimin vetëm provave të prezantuara nga paditësi, ndërsa nuk mori për bazë vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (KPMK). Ky pretendim është tërësisht i pabazuar për faktin se gjykata e shkallës së parë ka administruar të gjitha provat e prezantuara nga palët ndërgjyqëse, e të cilat kanë qenë vendimtare për zgjidhjen e çështjes konkrete. Nga përmbajtja e aktgjykimit të plotfuqishëm, rezulton se ligjshmëria e vendimit të KPMK ka qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor sipas aktgjykimit C1.502/2007, ku në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të referuar, përveç vendimeve të nxjerra nga e paditura, gjykata ka anuluar si të kundërligjshëm edhe Vendimin e KPMK me nr. 2136/07, dt. 30.10.2007. Prandaj, në situatën e tillë, një vendim nul në të cilën thirret e paditura në ankesën e parashtruar, nuk ka fuqi tjetër provuese përveç asaj të konstatuar si në aktgjykimin e formës së prerë, se paditësit me vendim të kundërligjshëm i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Prndaj, nga të cekurat më lartë, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për bazueshmërinë e kërkesëpadisë së paditësit është i drejtë dhe i argumentuar. Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar, gjykata ankimore e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë edhe për zbatimin e drejtë të dispozitave materialo - juridike në të cilat është thirrur me rastin e vendosjes nga edhe ka rrjedhur bazueshmëria e kërkesëpadisë së paditësit, pasi që zbatimi i këtyre dispozitave në përputhje me konstatimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, argumenton plotësisht qëndrimin se kërkesëpadia e paditësit në rastin konkret është e themeltë. Për këtë arsye gjykata e shkallës së dytë gjen se ankesa e të paditurës në rastin konkret është e pabazuar.

Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket vendimit për shpenzimet e procedurës, pasi që të njëjtat janë gjykuar në përputhje me nenin 449 dhe 452.2 të LPK-së.

Nga arsyet e parashtruara më sipër dhe në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.766/2020, me datën 10.09.2024

Kryetarja e kolegjit
Hunaida Pasuli